Co-PLAN
INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT
INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E HABITATIT

dldp
decentralisation and local development programme

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Conderazione Svizzera
Confederaziun svicra

Swiss Agency for Development
And Cooperation SDC

BASHKIA E PUKËS

HELVETAS
Swiss Intercooperation
ALBANIA

KAPITALIZIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA NGA PLANI LOKAL PËR MANAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE NË BASHKINË PUKË

Co-PLAN INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN E HABITATIT

dldp decentralisation and local development programme

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Conderazione Svizzera
Confederaziun svicra

Swiss Agency for Development And Cooperation SDC

BASHKIA E PUKËS

HELVETAS Swiss Intercooperation ALBANIA

Kapitalizimi i Praktikave të Mira nga Hartimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane

Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Pikënisja
3. Praktikat e Mira
4. Bashkëpunimi
5. Transferimi i Njohurive dhe Ngritja Kapaciteteve

Filozofia e programit:

DLDP "Decentralisation and Local Development Programme" për nga natyra e saj ofron asistencë teknike dhe mbështjetje përmes programveve të cilat krijojnë lidhje bashkëpunumi midis Bashkive në Veri të Shqipërisë, përmirësime cilësore të infrastrukturës, shërbmieve publike etj. DLDP ka mbështetur Bashkinë Pukë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve duke krijuar terrenin e përshtatshëm për kapitalizimin e një Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, si edhe mbështetje teknike për studime mbështetëse dhe investime konkrete në përmirësimin e infrastrukturës për këtë shërbim dhe rritjen e cilsëisë së tij.

Shënim: Kjo metodologji e prezantuar është e vlefshme për kapitalizimin e projekteve të ngjashme dhe shërben për informim të personelit që e ofrojnë këtë shërbim si edhe qytetarëve për t'u njohur më nga afër me situatën dhe projeksionet e lindura nga Proçesi Planifikimit për Menaxhimin e Mbetjeve

1. HYRJE

Dokumenti i kapitalizimit të praktikave më të mira për PLMIMNU të Bashkisë Pukë është parshikuar që të lehtësojë tranferimin e njohurisë dhe midis pjestarëve të adminsitratës së Bashkisë, Njësive Administrative si edhe të gjithë personave të tjerë të interesuar në veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve urbane gjithashtu, dhe kryesisht në funksion të informimit të publikut të gjerë të cilët nëpërmjet kontributit të tyre direkt impaktojnë cilësinë dhe nivelin e ofrimit të këtij shërbimi.

Fokusi i këtij kapitalizimi konsiston në transferimin e njohurive pasi të gjithë praktikat pozitive janë tashmë të identifikuara dhe të trajtuara nga proçesi i planifikimit ku më konkretisht ato mund të listohen:

- Indentifikimi i praktikave më pozitive gjeneruar gjatë proçesit të planifikimit,
- Krijimi i urave të komunikimit dhe bashkëpunimit midis palëve të interesuara dhe palëve të treta me qëllim shkëmbimin e ekesperiencave dhe praktikave më pozitive.
- Të bëj të mundur që të gjitha përfundimet dhe gjetjet kryesore të transmetohen dhe komunikohen të një numër sa më i gjërë individësh, kjo si një mjet punë i domosdoshëm për interpretimin e saktë të sektorit dhe shërbimit.

2. PIKËNISJA

Praktikat më të mira janë një produkt i cili është gjeneruar si rrjedhim llogjik i përfundimeve dhe gjetjeve të realizuara gjatë proçesit të hartimit të planit për menaxhimin e mbetjeve të ngruta urbane. proçes i cili shoqërohet me vlerësimin e situatës ekzistuese në terren për ofrimin e këtij shërbimi si edhe monitorime të kryera në funksion të interpretimit të indikatorëve në gjëndjen e tyre fillestare.

Bashkia Pukë ka vendosur si politikë orientuese "Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe Turistik të Vëndit nëpërmjet një Mjedisi të pastër dhe atraktiv për të gjithë". Në këtë kontekst është zhvilluar edhe PLMIMNU i cili është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, ky si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për manaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Pukë.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen e këtij sektori si edhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMMNU është parashtrimi i një përqasje të qartë të politikave të manaxhimit të mbetjeve në nivel lokal, duke harmonizuar interesat e të gjithë aktorëve dhe publikut të cilit ky shërbimi i ofrohet për të siguruar një manaxhim më efikas dhe të qëndrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë impiantet e përshtatshme për trajtimin final të mbetjeve.

Praktikat e mira zakonisht janë të ndërtuara mbi metodologjinë që reflekton qasjen ndaj Indikatorëve të Performancës, zhvilluar nga vetë dldp si edhe bazohet në pilotimet e ndryshme të hartuara në funksion të zbatimit korrekt të PLMIMNU.

Gjatë implementimit të projektit për PLMIMNU, Co-PLAN dhe MetroPolis në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Pukë dhe me mbështetjen e dldp ndoqën një seri aktivitetesh konkretisht të shprehura në mënyrë të listuar më poshtë si hapat bazë të ndjakura në proçesin e planifikimit të menaxhimit të mbetjeve:

Hapi 1. Krijimi i strukturave organizative
Hapi 2. Vlerësimi i gjëndjes ekzistuese
Hapi 3. Planifikimi operacional i menaxhimit të mbetjeve
Hapi 4. Planifikimi financiar i menaxhimit të mbetjeve
Hapi 5. Konsultimet dhe zbatimi i planit.

Në hapa të ndryshëm të hartimit të planit, grupi i punës organizoi seanca diskutimi dhe konsultimi me përfaqësuesit kryesorë të bashkisë. Procesi i konsultimit, i cili çoi në punën e ngushtë midis aktorëve, duke rakorduar në ato që i nevojiten bashkisë, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme.

Përfaqësuesit e Bashkisë Pukë kanë asistuar gjatë gjithë kohës gjatë lëvizjeve në terren dhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekziztuese të ofrimit të shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë së madhe.

3. PRAKTIKAT E MIRA

Performance Based Indicators Methodology

Këtu mund të përmëndet **implementimi i metodologjisë bazuar në Indikatorët e Performancës** e cila ishte një praktikë e re për stafin e Bashkisë por gjithashtu mjaft efiçente në matjen praktike dhe teorike të rezultateve progresive të arritura si pasojë e ndërhyrjeve apo investimeve në këtë shërbim.
Për të vlerësuar punën e sektorit të menaxhimit të mebtjeve dhe mjedisit të saj rrethues indikatorët e përdorur mbeten si mëposë:

- Efiçensa në grumbullimin e mbetjeve
- Efektiviteti në adresimin e ankesave të klientëve
- Efiçensa në shtrirjen e shërbimit dhe pastrimin e rrugëve
- Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mebtjeve në burim
- Shkalla e trajtimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin
- Shkalla e mbrojties së mjedisit në trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve
- Shkalla e rikuperimit të kostos së shërbimit të ofruar
- Efiçensa në mbledhjen e tarifës
- Vlerësimi i përshtatshmërisë së politikave kombëtare të MM përfshirë edhe zbatimin e tyre
- Shkalla e koherencës së institucioneve lokale

Nëpërmjet kësaj metodologjia stafi u përgatit dhe mësoi më tepër përsa i përket:

1. Megjithëse rezultatet pozitive për disa nga indikatorët qëndrojnë në nivele të larta, saktësia e tyre lë mjaftueshëm për të dëshiruar, çka nënkupton se duhet punuar më tepër përsa i përket dokumentimit të shërbimit, evidencave mujore, mbledhjes së tarifës dhe përmirësimit të shërbimit të ofruar.
2. Mbajta e evidencave periodike duke vlerësuar në mënyrë korrekte këto indikatorë, shërben si një arkivë e domosdoshme për analizat vjetore si edhe në parashikimet vjetore që Bashkia realizon për planifikimin e buxhetit dhe politikave që ndjek hap pas hapi.

Ofrimi i Shërbimit për Zonat e Varfëra në Bashkinë Pukë

Në vijimësi të vlerësimit të prakitkave më pozitive të implementuara gjatë hartimit të PLMIMNU mund të përmëndet gjithashtu se një analizë për ofrimin e shërbimit në zonat e varfëra është relaizuar në bashkëpunim me autoritetin lokal në mënyrë që objektivi për të shtrirë shërbimin në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë të arrieht me sukses.

Duhet theksuar se në këtë pikë vështirësitë nuk lidhen vetëm me situatën social-ekonomike të zonave por edhe me infrastrukturën dhe terrenin e vështirë në të cilën ato janë pozicionuar.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta ka filluar të konsiderohet si nje praktikë e domosdoshme në zonat rurale. Banorët e zonave rurale duhet të kenë angazhimin maksimal në mënyrë që të sigurojnë rrugë të pastra dhe një mjedis rural të shëndetshëm. Në Bashkinë Pukë shërbimi i grumbullimit dhe tarnsportit të mbetjeve ofrohet në një pjesë të mirë të territorit por sërisht ka mjaftueshëm zona të pashërbyera pasi nuk ka asnjë lloj infrastrukture për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve.

Në pjesën më të madhe të rasteve këto zona ndodhen në distanca të largëta mbi 10km nga qendrat e banuara dhe infrastruktura rrugore është e vështirë për shkak të terrenit malor dhe rrugëve në gjendje të keqe. Një pjesë e këtyre zonave gjenerojnë një sasi shumë të vogël mbetjesh, ku një pjesë të tyre (si ato organike) i kompostojnë për pleh organik, ose i përdorin për ushqim për kafshët.





Përveç NjA Pukë, ku shërbimi nuk ofrohet në fshatin Lajthizë për shkak të terrenit të thepisur, në të gjitha NjA të tjera shërbimi nuk ofrohet në disa fshatra për shkak të territorit të vështirë për të shkuar në zonat e tyre të banuara, largësisë shumë të madhe dhe sasisë shumë të vogël të mbetjeve që ata gjenerojnë dhe një nga arsyet kryesore të mos ofrimit të shërbimit të grumbulluimit dhe transportimit të mbetjeve, janë : lidhja e dobët infrastrukturore e NjA, shpërndarja e vendbanimeve në mënyrë difuzive dhe numri i vogël i familjeve si edhe rentabiliteti i ulët ekonomik.

Në mënyrë që të gjithë fshatrave t'ju ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve duhet që të hartohet një skemë e menax-himit të mbetjeve të ngurta. Fillimisht, duhet të përcaktohen rrymat e mbetjeve që gjenerohen gjatë aktivitetit njerëzor në zonat rurale. Mbetje të tilla, si mbetjet nga frutat dhe zarzavatet, lulet, ushqimet e mbetura, mbetjet e kopshteve mund të klasifikohen si mbetje të biodegradueshme.

Për këtë rrymë të mbetjeve qytetarët e zonve rurale në Bashkitë Pukë mund t'i kompostojnë dhe mund t'i përdorin si pleh në kopshtet e tyre. Sa i takon mbetjeve të ngurta, të tilla si: letra, karton, dërrasa, shishe qelqi, etj. këto mbetje duhet të ngumbullohen individualisht nëpër shtëpi dhe më pas të dërgohen tek blerësit e materialeve të ricikluesshme, duke siguruar të ardhura kundrejt sasisë që dorëzojnë. Në zonat rurale, në shtëpitë e banorëve të zonave dhe në kopshtet e tyre gjenden dhe mbetje të cilat klasifikohen si të rrezikshme dhe të pa ricikluesshme. Mbetje të tilla duhet të hidhen në për koshat e vendosur, duke siguruar kështu një sasi më të vogël të grumbulluar.

Lista me qëndrat e banura të cilat konsiderohen si zona të varfëra ku shërbimi planifikohet të ofrohet e të subvencionohet.

Bashkia Pukë

NjA Qerret	Dush, Pla, Tejkoder, Vrrith, Korthpule, Kaftalle, Karme, Plet
NjA Qelez	Bushat Dushnezë, Midhe, Buzhalë, Levrushk Qerret i Vogël
NjA Rrape	Breg, Kabash Buhot, Meqe, Lumzi
NjA Gjegjan	Dom, Rras, Kuzhnen, Kimez, Kalivare, Mesul
NjA Pukë	Lajthizë

Mbetjet e rrezikshme dhe të paricikluesshme duhet që të transportohen nga koshat drejt pikave të transferimit ose drejt landfillit. Më poshtë jepet një skemë e thjeshtë e menaxhimit të mbetjeve në fshatrat e Bashkisë së Pukës (fig. 1). Banorëve, të cilëve nuk i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve duhet t'ju sigurohet një model më i përshtatshëm në mënyrë që të shërbehen nga bashkia.

Në raste të tilla, bashkia duhet t'ju sigurojë atyre një "kalendar aktivitetesh" me të gjitha detajet kur dhe ku do të kaloj shërbimi i grumbullim transportit. Për mbetjet të cilat duhet të kompostohen, bashkia duhet që t'i sigurojë banorëve koshat e përshtatshëm të kompostimit. Ndërkohë që mjetet që do të lëvizin në terrent e thepisura dhe të vështira do të jenë të laternuara motorrike deri në pikën ku e lejon infrastruktura lëvizjen e më pas me mjete alternative (motorrike të vogla ose edhe me qerre / kafshë për largësi të vogla).

Për materialet e ricikluesshme, banorët duhet të vendosen në kontakt me një blerës të këtyre materialeve. Bashkia e cila siguron mbledhjen e mbetjeve të ricikluesshme duhet të përcaktojë paraprakisht një ditë të javës, e cila do të jetë e vlefshme edhe për blerjen e "produkteve" të grumbulluara nga banorët e zonës.

Për materialet të cilat do të duhet të depozitohen në stacionet e transferimit apo në landfill, banorët duhet t'i vendosin ato nëpër koshat e vendosur nëpër lagjie. Reduktimi i bërë që në burim për rrymat e tjera të mbetjeve sjell zvogëlimin e sasisë së mbetjeve nëpër kosha.

Duke qënë se fshatrat janë të vendosur në mënyrë të shpërndarë dhe aksesueshmëria e tyre është e vështirë, rekomandohet që mbledhja e mbetjeve të kryhet me triçikël dhe në mënyrë përiodike, çdo javë.

Rehabilitimi i Vendepozitimit të Mbetjeve Urbane në Fushë-Qarr:

Në kuadër të investimit në infrastrukturën e shërbimit publik të menaxhimit të mbetjeve, nevoja emergjente për të hedhur si hap të parë drejt përmbushjes së objektivave kombëtare për trajtim plotësisht të integruar të mbetjeve dhe miqësor me mjedisin, në Bashkinë Pukë po ndërmerren hapa konkretë për izolimin dhe mbylljen e të gjithë vend-depozitimeve ilegale në afërsi të Nj.A-ve dhe qëndrave të banuara si edhe rehabiltimi i vend-depozitimit të Fushë Qarrit i cili përdoret nga Bashkia Pukë për depozitimin final të mbetjeve prej më shumë se një dekade.



Duke qënë se në versionin final të dakordësuar në PLMIMNU Bashkia Pukë duhet që fillimisht të impelementoj skemën e diferencimit të mbetjeve dhe reduktimit të sasisë që do të dërgohet për depozitim final dhe më pas nëpërmjet impelmentimit të një Stacioni Transferimi, mebtet të depozitiohen në Landfillin e Qëndrës së Qarkut pra në Bushat.

Projekti pilot i hartuar për rehabilitimin e Vend-Depozitimit në Fush Qarrë po vihet në zbatim nga Bashkia Pukë me ndihmën dhe mbështjeten e dldp. Ndërkohë që kjo si një praktikë tepër pozitive do të trajtohet në një dokument të veçuar bashkangjitur me këtë.

Takime me publikun dhe ngritja kapaciteteve të administratës dhe infrastrukturës:

Takimet me publikun dhe aktivitete për rritjen e kapaciteteve janë organizuar që në gjenezën e fillimit të hartimit të analizës së gjëndjes ekzistuese të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe janë ndjekur më pas me aktivitete të cilat konsistonin në ndarjen e informacionit mbi gjetjet dhe efiçentimin e sistemit si edhe aspektet që lidhjen me efiçentimin e intinerareve dhe çështjeve ekonomike të sistemit.

Co-PLAN dhe Bashkia Pukë kanë organizuar mbi 3 dëgjesa me publikun ku janë ndarë të gjitha variantet e mundshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, teknika të ndryshme të kompostimit me qëllim reduktimin e sasisë finale për depozitim, llogaritjet e kostove të shërbmimit sipas metodologjisë dhe formatit të siguruar nga dldp.

Gjithasthu është asistuar stafi i Bashkisë Pukë për të realizuar proçesin e tenderimit për blerjen e një mjeti teknologjik për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve nëpërmjet mbështetjes financiare të dlddp-së.

Bashkia Pukë ka ndihmuar vazhdimisht në komunikimin progresiv të qytetarëve mbi rëndësinë e pagimit të tarifës dhe ndarjes në burim të mbetjeve si edhe masa konkrete për reduktimin e sasisë së mbetjeve të gjeneruara qoftë nga njëstië familjare por edhe nga biznesi ' Ndarja e këtij infromacioni ka qënë një prioritet i mbështjetjes dhe Bashkia Pukë është treguar mjaft konkrete në veprimet e ndërmarra në komunitet ku fton vazhdimisht qytetarët për modifikimin e sjelljes së tyre karshi gjenerimit dhe menaxhimit të mebtjeve personale/-familjare.



4. BASHKËPUNIMI

Partnerët e gatëshëm për të kontribuar në realizimin e suksesshëm të një projekti si edhe ndarjene eksperiencave, mendimeve dhe praktikave të mëparshme mes tyre, janë çelësi i suksesit për arritjen e objektivave të vendosura gjatë kësaj mbështjetje.

Co-PLAN u përfshi nëpërmjet ekspertëve të tij në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe financave duke vendosur mardhënie konkrete me drejtoritë respektive në administratën e Bashkisë Pukë si edhe duke vendosur kontakte në terren me banorë të cilët kishin mendime dhe qëndrime potenciale mbi shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu pjesë e rrjetit të bashkëpunimit ishin edhe Njësitë Administrative të cilat janë prëfaqësuar nga kryetarët e tyre në mbledhjet e zakonshme me Kryetarin e Bashkisë si edhe nga kryepleq dhe banorë të thjeshtë.

Përfituesit konkrete nga ky bashkëpunim janë:

- Këshilltarët dhe Drejtuesit e Njësive Administrative
- Banorët e Bashkisë Pukë
- Bizneset
- Orgnaizatat e ndryshme lokale dhe rajonale
- Shkollat publike dhe private të zonës
- ARM dhe IMP
- Media Lokale

Bashkia Pukë përmes proçesit të ngritjes së urave të komunikimit me qytetarët dhe palët e interesuara në funksion të menaxhimit të mbetjeve përgjatë kohës që u realizua edhe PLMIMNU u siguruar jo vetëm që të reflektoj të gjitha komentet e reflektuara në këtë fazë por edhe të përforëcoj këto lidhje në funksion të monitorimit dhe zbatimit të mëtejshëm të planit, ku rol krysor ka komunikimi në kohë reale ndërmjet palëve të përfshira në proçes.

Gjithashtu Bashkia ka marrë përsipër që të angazhohet në organizimin periodik të dëgjesave publike dhe komunikimieve të vazhdueshme nëpërmejt spoteve publicitare dhe publikimeve në afishimet e Bashkisë qoftë në WEB dhe të printura, e gjithë kjo në funksion të rritjes së ndërgjegjies qytetare në funksion të efiçentimit të sitemit të menaxhimit të mbetjeve.

5. TRANSFERIMI I INFORMACIONIT DHE NDËRGJEGJËSIMI

Si aneks i PLMIMNU është vendosur edhe një program për ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me proçesin e menaxhimit të mbetjeve dhe skemave të minimizimit të tyre.
Ky program, do t'iu vijë në ndidhmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për të zhvilluar procesin e kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambjentet e shkollave.
Objektivat e fushatës ndërgjëgjesuese dhe informuese do të konsistojë si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me skemat e reja të manaxhimit të mbetjeve, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre;
2. Ndërgjëgjësimin dhe rritja e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbetjeve;
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbetjeve në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit;

4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e kompostimit, dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për kompostimin e mbetjeve organike;
5. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me procesin se si do të kryhet kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave të kompostimit;
6. Prezantimin e skemave të ndryshme të kompostimit për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë;
7. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të kompostimit të mbetjeve organike;
8. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e kompostimit;
9. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.

Konkretisht ky plan do të vihet në jetë nëpërmjet realizimit të hapavae të mëposhtëm:
Hapi I: Veprimtari dhe Aktivitete në funksion të ndërgjegjësimit (në zona pilot do të implementohen teknika dhe mënyrat e duhura për menaxhimin e mbetjeve.
Hapi II: Rritja e Interesit, parashikohet që në një fazë të dytë bashkia të ofroj mbështjetje teknike dhe subvencionim për ato njësi familjare, biznese që duan të realizojnë proçese kompostimi dhe riciklimi të mbetjeve.
Hapi III: Vlerësimi dhe përmirësim progresiv, në këtë pjesë bashkia ndërmerr fushata monitorimi të shërbimit në baza mujore ku raportohet situata dhe përmirësimet ndodhin në kohë pa degraduar sistemi.